



Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 8, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.6, neni 14, paragrafi 2, nën-paragrafi 2.14 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr.03/L—185);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_V_983_06_13**;
- Ankesa e KEDS-it e datës 19.07.2013.

në seancën e mbajtur më datë 06 shtator 2013, nxorri këtë:

V E N D I M

- I REFUZOHET** ankesa e KEDS-it ndaj vendimit të DMK-së për konsumatorin D. Gj. (shifra e konsumatorit: DPR – 270995) nga Prishtina ndaj vendimit të DMK-së, si në arsyet e paraqitura në arsyetimin e këtij vendimi.
- II MBETET në fuqi** vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve nr. ZRRE/DMK_V_983_06_13 i datës 26.06.2013.

Arsyetim

Punëtorët e autorizuar të KEK-ut për inspektimin e pikave matëse me datë 15.06.2006 kanë bërë inspektimin e pikës matëse të konsumatorit të shifrës DPR – 270995 dhe kanë konstatuar se njehsori elektrik nuk posedon kapakun, pronari deklaroi se me datën 13.06.2006 rreth orës 16³⁰ kanë vërejtur se njehsori elektrik i mungon komplet kapaku si dhe janë të hekura bllombat shtetërore se bashku me kapakun, gjithashtu është rekomanduar se ky njehsor duhet të shkojë në qendrën e kalibrimit për verifikim.

Pas kësaj me datë 28.03.2008 punëtorët e autorizuar të KEK-ut për ndërrim njehsori kanë dalë te konsumatori dhe kanë bërë ndërrimin e njehsorit elektrik, ku kanë hequr nga matja njehsorin elektrik nr. 32266664 dhe kanë vendosur për matje njehsorin elektrik nr. 44935618, dhe kanë konstatuar se ndërrimi i njehsorit elektrik është bërë sipas kërkesës së shërbimit të kontrollës, gjithashtu është konstatuar se konsumatori furnizohet me kabull 4x6 mm.

Punëtorët e autorizuar të qendrës së kalibrimit me datë 16.04.2008 kanë bërë kontrollimin detal (verifikimin) e njehsorit elektrik nr. 32266664 dhe kanë konstatuar se njehsori elektrik është pa bllomba shtetërore dhe pa kapak të epërm dhe shtëpiza e poshtme e thyer, nga ana e jashtme dëmtime tjera nuk ka, në brendi të njehsorit numëruesi është i manipuluar ka gjurmë të kthimit mbrapa numrave të numërorit, si dhe tabela e njehsorit nga ana e brendshme e gërvishur, disku i dëmtuar nuk mund të sillet. Me datë 17.04.2008 punëtorët e autorizuar të qendrës së kalibrimit është lëshuar protokoll mbi shqyrtimin e njehsorit elektrik, ku është konstatuar se njehsori nuk mund të shqyrtohet pasi që diskun e ka të dëmtuar.



Me datë 21.06.2008 punëtorët e autorizuar të KEK-ut për inspektimin e pikave matëse kanë bërë inspektimin e pikës matëse të konsumatorit të shifrës DPR – 270995 ku kanë konstatuar se me kërkesë të qendrës së kalibrimit në procesverbalin nr. 22311 të datës 17.04.2008 kemi dalë për të marrë seksionin e kabullit furnizues.

Pas këtij veprimi Departamenti për Faturim në KEK e ka ngarkuar konsumatorin me ngarkesë për shfrytëzim të paautorizuar të energjisë elektrike me anë të faturës DPR08HP06311 në vlerë prej 1,332.39€. Pas ngarkesës së bërë nga KEK-u konsumatori me datë 21.07.2008 ka parashtruar ankesë në Departamentin për konsumator në KEK duke kundërshtuar ngarkesën për shfrytëzim të paautorizuar. Me datë 08.08.2008 Departamenti për Konsumator në KEK i është përgjigjur konsumatorit duke e refuzuar dhe duke u thirrur në Procedurën e përkohshme për identifikimin dhe parandalimin e shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë elektrike, procedurën e përkohshme të faturimit dhe leximit të konsumatorëve shtëpiak si dhe procesverbalet e kontrollës dhe kalibrimit.

Pas përgjigjes së KEK-ut konsumatori ka parashtruar ankesë në Departamentin për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE. DMK pas ankesës së konsumatorit ka shqyrtimin e ankesës dhe me datë 05.06.2013 ka nxjerr vendim duke e **aprovuar** ankesën e konsumatorit dhe duke kërkuar nga KKDFE që të shkarkojë shifrën e konsumatorit DPR – 270995 nga fatura e rikthimit të humbjeve DPR08HP06311 të datës 17.07.2008 në vlerë prej 1,332.39 €.

Pas marrjes së vendimit të DMK-së, me datë 18.07.2013 KEDS-i ka parashtruar ankesë në Bordin e ZRRE-së ndaj këtij vendimi, për shkak të konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes, si dhe zbatimit të gabuar të dispozitave ligjore.

Baza e kundërshtimeve të KEK-ut të theksuara në ankesë është se sektori i kalibrimit ka konstatuar se bllobat shtetërore janë të manipuluar, ndërsa numëruesi i njehsorit është i manipuluar dhe ka gjurmë të kthimit prapa të numrave në numëror dhe se mbi këtë bazë është llogaritur fatura e rikthimit të humbjeve. Në ankesë po ashtu theksohet se konstatimin e departamentit të kalibrimit e argumenton edhe rrjedha e energjisë aktive ku shihet edhe ndryshimi i kilovatëve të shpenzuar, si dhe është theksuar se jo gjithmonë rrjedha e energjisë së shpenzuar është treguesi vërtetë se nuk ka manipulim me njehsorin elektrik.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 09 shtator 2013 ka analizuar të gjitha dëshmitë e paraqitura nga ana e KEK-ut, përkatësisht bazën e kundërshtimit, me të cilën pretendohet se DMK, gjatë vendosjes së kësaj çështje nuk ka vlerësuar mirë provat dhe faktet e prezantuara. Bordi i ZRRE-së ka analizuar procesverbalet e KEK-ut nr. 007839 të datës 15.06.2006 dhe nr. 003506 të datës 28.03.2013 dhe ka vërejtur se përkundër këtij konstatimit të punëtorëve të KEK-ut në procesverbalin nr. 007839 se njehsori elektrik nr. 32266664 nuk posedon kapakun dhe mungojnë bllobat shtetërore deri me datë 28.03.2008 nuk ka ndërmarrë asnjë veprim për të ndërruar njehsorin elektrik, pra për afro 21 muaj nuk ka ndërmarrë asnjë veprim për të ndërruar atë njehsor elektrik. Bordi thekson se po që se punëtorët e autorizuar të KEK-ut kanë vërejtur ndonjë parregullsi me njehsorin elektrik do të duhej të vepronin konform dispozitave të nenit 6 të Procedurës së përkohshme për identifikimin dhe shfrytëzimin e paautorizuar të energjisë elektrike në mënyrë që të mënjanoi parregullsitë në njehsor elektrik.

Bordi i ZRRE-së ka analizuar edhe shpenzimin e energjisë elektrike me shpenzimet e bëra me njehsorin e vjetër nr. 32266664 dhe me njehsorin e ri nr. 44935618 dhe ka vërejtur se mesatarja mujore e shpenzimit të energjisë elektrike me njehsor të vjetër ka qenë 696 kWh/muaj, ndërsa mesatarja mujore e shpenzimit të energjisë elektrike me njehsor të ri është 599 kWh/muaj, e që në të vërtetë paraqet në rënie të shpenzimit me njehsor të ri. Po ashtu është analizuar shpenzimi i energjisë elektrike edhe një vit para dhe pas ndërrimit të njehsorit elektrik, ku 12 muaj para vendosjes së njehsorit të ri shpenzimi mesatar mujor ka qenë 1062 kWh/muaj (regjistruar në njehsorin e vjetër), ndërsa 12 muaj pas vendosjes së njehsorit të ri shpenzimi mesatar mujor ka qenë



633 kWh/muaj (regjistruar në njehsorin e ri). KEDS-i në ankesën e tyre ka theksuar se konstatimi i Departamentit të Kalibrimit në njëfarë mase e argumenton edhe analiza e rrjedhës së energjisë aktive, ku shihet ndryshimi i kilovatëve të shpenzuar para dhe pas vendosjes së njehsorit elektrik, mirëpo kjo nuk qëndron ngase sipas analizave të shpenzimit ka rezultuar se shpenzimi i energjisë elektrike me njehsorin e ri është më i ulët se sa me njehsorin e vjetër, e që po të argumentohej konstatimi i kalibrimit atëherë do të duhej që shpenzimi i energjisë elektrike t'i rritej me njehsorin e ri e jo të zvogëlohej.

Sipas Procedurës për identifikimin dhe shfrytëzimin e paautorizuar të energjisë elektrike përkatësisht nenit 8 thuhet se: *Konstatimet e parregullsisë funksionale të njehsorit elektrik siç përcaktohet në nenin 3 paragrafi i) të konstatuara në laboratorin e kalibrimit nuk mund të përdoren si provë e vetme meritore për ngarkimin e konsumatorit me faturën e rikthimit të energjisë së humbur.*

Bordi i ZRRE-së ka vërejtur se kjo pikë matëse gjendet e vendosur në ndërtesë kolektive dhe se këta njehsor elektrikë janë tërësisht të pa mbrojtur ku mund të ketë çasje çdokush në këta njehsor, andaj për sigurimin e tyre është kompetencë e KEK-ut, pasi që të gjithë njehsorët elektrik janë aset i KEK-ut.

Po ashtu janë analizuar edhe listat e leximit të KEK-ut prej periudhës 05/2007 – 08/2007 dhe ka vërejtur se në këto listat të leximit është evidentuar se njehsori elektrik nr. 32266664 është në rregull dhe ka vulën distributive në rregull, si dhe është evidentuar edhe shpenzimit i regjistruar në njehsorin elektrik.

Bordi i ZRRE-së ka vlerësuar se KEDS në ankesën e tij nuk ka prezantuar asnjë provë të vetme me të cilën e vërteton faktin se vendimi i DMK-së nuk është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligj, si dhe në disa raste edhe kundërthënëse, andaj si të tilla nuk paraqesin bazë të mjaftueshme për prishjen e këtij vendimi.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 09.09.2013 ka analizuar ankesën e konsumatorit dhe vendimin e nxjerr nga DMK nr. ZRRE/DMK_V_983_06_13, dhe pas analizimit të hollësishëm të të gjitha dëshmimeve tjera të prezantuara në shkresat e lëndës ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

- III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.



Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimet të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së

Enver Halimi, kryesues

Përparim Kabashi, anëtar

Blerim Koci, anëtar

Merita Kostari, anëtare

Krenar Bujupi, anëtar